



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë, më 23.01.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), PËR FINANCIMIN SHITESË TË PROJEKTIT “SIGURIA E DIGAVE”, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.40/2012”

Hyrje

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23.01.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave” të ratifikuar me ligjin Nr 40/2012”. Komisioni për Politikën e Jashtme caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Evis Kushi.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm znj. Dorina Çinari, Zëvendësministre për Infrastrukturën dhe Energjinë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i letër-marrëveshjes ndryshuese, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin shtesë të projektit “Siguria e digave”, të ratifikuar me ligjin nr.40/2012.

Letër-marrëveshja ndryshuese synon të realizojë rishpërndarjen e fondeve në shumën 461.250 euro nga kategoria e katërt e projektit (kategori e papërcaktuar), në kategorinë e parë të projektit si dhe të ndryshojë datën e mbylljes, duke e shtyrë deri më 31.12.2020.

Duke qenë se aktivitetet në kuadër të projektit “Siguria e digave” kërkojnë kohë dhe fonde shtesë, si dhe kanë kaluar limitin e angazhimit fillestar kontraktual, nëpërmjet letër-marrëveshjes propozohet rishpërndarja e fondeve të lira të kategorisë 4 në kategorinë 1, “Mallra dhe punime”, për punimet shtesë në rehabilitimin elektromekanik të HEC-it Koman. Ndryshimi nga një kategori në tjetrën në lidhje me këto fonde, nuk cënon aktivitetet e planifikuara sipas marrëveshjes së kredisë. Për sa më lart, duke patur parasysh se aktivitetet shtesë do të kërkojnë kohën për zbatimin e tyre është propozuar edhe shtyrja e datës së mbylljes së kredisë deri më 31.12.2020.

Bazuar në ligjin Nr. 40/ 2012 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillimin (IBRD) për financimin shtesë të projektit “Siguria e Digave”, objektivat e këtij projekti janë:

- Të kontribuojë në mbrojtjen e digave hidroelektrike të kaskadave të lumit Drin dhe Mat në territorin e huamarësit;
- Të përmirësojë efektivitetin operacional të digave të lartpërmendura hidroelektrike dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e furnizimit me energji në tregun rajonal.

Në kuadër të efekteve financiare, projekti për sigurinë e digave, është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH sh.a, për periudhën 2018-2020.

ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatorja znj. Kushi u theksua se letërmarrëveshja ndryshuese kërkon vetëm rishpërndarjen e fondeve, dhe shtyrjen e afatit, pa shpenzime shtesë në buxhetin e planifikuar. Komisioni u interesua mbi afatin fillestar të marrëveshjes dhe arsyet e kërkesës për shtyrjen e tij për në 31.12.2020. Deputetët në komision u interesuan mbi arsyet e kërkesave të vazhdueshme për rialokime dhe mbi nevojën për t'i paraqitur këto kërkesa përpara komisioneve parlamentare.

REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Bazuar në konstatimet e komisionit sa i takon teknikës legislative, i propozojmë Komisionit Përgjegjës që në paraqitjen e projektligjit të përcaktohen nenet për tekstin përkatës, të cilat mungojnë.

PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Politikën e Jashtme pasi vlerësoi se:

- a) Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

EVIS KUSHI

KRYETARE

MIMI KODHELI